



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 2  
25.04.2012

NR. VENDIMI 2  
06.02.2013

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

**K/SEANCE - Ardit Mustafaj**  
**ANËTAR - Nertina Kosova**  
**ANËTAR - Klodian Kurushi**

Asistuar prej sekretares Olta Sinanaj, në disa seanca gjyqësore publike, deri sot me dt.06.02.2013, mori në shqyrtim çështjen civile nr.2/5 akti, dt.25.04.2012 regj., që u përket palëve:

**PADITËS:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përfaqësuar nga prokurori Besnik Muçi.

**I PADITUR:** R.(A.) D., i biri i V.(F.) dhe F. (F.), i datëlindjes xxx, lindur në xxx, xxx, aktualisht banues në xxx, Njësia Bashkiake nr.x, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plotë për të vepruar, i përfaqësuar me prokurën e posaçme nr.x rep., nr.x kol., dt.x nga av.E.L., Dhoma e Avokatisë xxx.

**PERSONA TË TRETË:** 1. Z.D., e bija e V. (F.) dhe F. (F.), e datëlindjes xxx, lindur në xxx, xxx, banuese në xxx, Njësia Bashkiake nr.x, rruga “xxx”, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plotë për të vepruar, e përfaqësuar me prokurën e

posaçme nr.xx rep., nr.xx kol., dt.xxx nga av.E.L.

**2. F. (F.) D.**, e bija e Th. (Sh.) dhe e M. (Z.), e datëlindjes xxx, lindur në xxx, xxx, banuese në xxx, xxx, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plotë për të vepruar, e përfaqësuar me prokurë me gojë para gjykatës nga av.E.L.

**3. V. (F.) D.**, i biri i D. dhe i S., i datëlindjes xxx, lindur në xxx, xxx, banues në xxx, xxx, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plotë për të vepruar, i përfaqësuar me prokurën e posaçme nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx nga av.E.L..

**4. Shoqëria “R.” Sh.p.k.**, me seli në xxx, rruga “xxx”, nr.xxx, me ortak të vetëm dhe përfaqësues ligjor D.Ç., në mungesë.

**5. Shoqëria “A.” Sh.p.k.**, me seli në xxx, rruga nacionale xxx, vendi i quajtur xxx, me ortak të vetëm dhe përfaqësues ligjor S.Sh., me adresë banimi lagja “xxx”, rruga “xxx”, nr.xxx, xxx, në mungesë.

**6. R.Z.**, i biri i B. dhe i L., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në xxx, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plotë për të vepruar, i përfaqësuar me prokurën e posaçme nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx nga av.E.B., Dhoma e Avokatisë xxx.

**OBJEKTI:** 1. Konfiskimi i pasurive të paluajtshme:

**Dy apartamente banimi** të ndodhur në xxx, Lagja “xxx”, në objektin “xxx” në administrim të shoqërive “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k., apartamenti i parë i ndodhur në katin

e gjashtë nga toka, me nr.xx, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> dhe apartamenti i dytë ndodhur në katin e shtatë nga toka, me nr.xx, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, të blerë nga i padituri R.D. me kontratën e porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx;  
**vetëm për pjesën që përfaqëson shumën xxx (dyzet e pesëmijë) euro të paguara nga i padituri R.D.**

· **Një apartament banimi** me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> të ndodhur në Tiranë, i regjistruar ne Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, me nr.xxx, ndodhur në zonën kadastrale nr.xxx, rruga “xxx”, blerë me dt.xxx nga personi i tretë Z.D.

**2. Konstatimi i pavlefshmërisë së veprimit juridik “revokim kontrate” me nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx** midis R.D. dhe shoqërive “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k. dhe të **kontratës për prenotim apartamenti me nr.xxx kol., nr.xxx rep., dt.xxx**, të lidhur midis shoqërive “xxx” Sh.p.k., “xxx” Sh.p.k. dhe R.Z., **për sa i përket vlerës prej xxx euro** të paguara nga i padituri R.D.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 5, 7, 15-22 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009

“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe dëgjoi:

-Përfaqësuesin e paditësit Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, prokurorin Besnik Muçi, i cili kërkoi:

-Pranimin e kërkesës për konfiskimin e pjesës prej xxx euro në raport me vlerën totale të dy apartamenteve të banimit me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> dhe xxx m<sup>2</sup>, të ndodhura në xxx, blerë nga i padituri R.D. me kontratën nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx.

-Konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit revokim kontrate nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx midis R.D., shoqërive “xxx” Sh.p.k. e “xxx” Sh.p.k. dhe të kontratës për prenotim apartamenti nr.xxx kol., nr.xxx rep., dt.xxx të lidhur midis shoqërive “xxx” Sh.p.k., “xxx” Sh.p.k. dhe R.Z., për sa i përket vlerës prej xxx euro të paguara nga i padituri R.D.

-Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen Zyrat e Përmbarrimit

Gjyqësor Vlorë dhe Tiranë, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme të ngarkohet z.D.Sh., administrator pranë Agjensisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara Tiranë.

-Hoqi dorë nga gjykimi dhe kërkoi pushimin e gjykimit të kërkesës për konfiskimin e apartamentit të banimit me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, i ndodhur në xxx, blerë nga personi i tretë Z.D. me kontratën dt.xxx dhe revokimin e masës së sekuestros të vendosur ndaj tij;

-Përfaqësuesin i të paditurit R.D. dhe personave të tretë Z.D., F.D. dhe V.D., av.E.L., i cili kërkoi rrëzimin e padisë së paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda, për shtetasit R.D., V.D., F.D. dhe Z.D., duke urdhëruar edhe heqjen e sekuestros së vendosur mbi këto pasuri në bazë të këtij procedimi;

-Përfaqësuesin e personit të tretë R.Z., av.E.B., i cili kërkoi rrëzimin e padisë së paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda, duke urdhëruar edhe heqjen e sekuestros së vendosur mbi këto pasuri në bazë të këtij procedimi;

Si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

### **VËREN SE:**

1. Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, me dt.10.12.2010, ka filluar hetimin pasuror sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim ligji nr.10192/2009), ndaj shtetasit shqiptar R.D., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, për shkak se ndaj tij dhe disa shtetasve të tjerë shqiptarë, K.D., G.D. dhe E.S., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx kishte filluar një procedim penal për këtë vepër penale, i regjistruar ky me nr.xxx, dt.xxx.

Vetë procedimi penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx rezulton se ka filluar mbi bazën e informacioneve të policisë gjyqësore dërguar me shkresën nr.xxxprot., dt.xxx të Drejtorisë së Policisë së Qarkut xxx, sipas të cilës rezulton se nëpërmjet oficerit të kontaktit të vendit tonë në Athinë është marrë informacion se autoritetet gjyqësore xxxe kanë ndaluar shtetasit shqiptarë të mësipërm dhe kanë nisur ndjekjen penale ndaj tyre, pasi ata dyshohen për kryerjen e disa vjedhjeve me armë dhe me dhunë të disa supermarketeve dhe dyqaneve xxxe, ku sasia e parave të vjedhura arrin në shumën xxx euro. Nga autoritetet xxxe është ngritur dyshimi se shtetasi R.D. dhe personat e tjerë të ndaluar në Xxx, me pasuritë e siguruara nga veprimtaria kriminale kanë blerë në Shqipëri prona të luajtshme e të paluajtshme, duke ngritur kështu edhe dyshime për kryerjen prej tyre të veprës

penale të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Nga hetimet e kryera nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, rezultoi se personi nën hetim R.D. kishte porositur ndërtimin e dy apartamenteve banimi në qytetin e xxx me anë të kontratës së porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx të lidhur mes tij dhe shoqërive ndërtuese “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k. Apartamentet e banimit ndodhen në lagjen “xxx”, në objektin “xxx” në administrim të shoqërive “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k., apartamenti i parë në katin e gjashtë nga toka, me nr.xx, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> dhe apartamenti i dytë në katin e shtatë nga toka, me nr.xx, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>. Sipas kontratës, vlera e përgjithshme e të dy apartamenteve është në shumën xxx (xxx) euro.

Nga hetimi i kësaj prokurorie rezultoi se edhe motra e personit nën hetim R.D., Z.D., kishte blerë një apartament banimi në qytetin e Tiranës, me kontratën e shitjes nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx. Apartamenti është me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ndodhet në rrugën “xxx” dhe është i regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, me nr.xxx, zona kadastrale nr.xxx. Sipas kontratës, apartamenti është blerë në shumën xxx (xxx) lekë.

Ndaj këtyre pasurive, në funksion të këtij procedimi penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx, me vendimet nr.xxx, dt.xxx dhe nr.xxx, dt.xxx, vendosi masën e sekuestros preventive sipas nenit 274 të K.Pr.Penale.

Edhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me kërkesë të Prokurorisë për Krime të Rënda, me vendimin nr.x, dt.xxx, bazuar në nenin 11 të ligjit nr.10192/2009, vendoi sekuestron e këtyre pasurive, në funksion hetimit pasuror të filluar sipas këtij ligji.

Më pas, me dt.xxx, procedimi penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal, u pushua nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, bazuar në nenin 328/1 germa “dh” të K.Pr.Penale, me arsyetimin se në gjëndjen që ishin aktet nuk mund të provohej se të dyshuarit e mësipërm kishin kryer veprën penale (sipas përmbajtjes së vendimit, autoritetet gjyqësore xxxe nuk i kanë kthyer përgjigje letërporosisë së dërguar nga kjo prokurori për marrjen e akteve dhe provave pranë këtyre autoriteteve në lidhje me aktivitetin e dyshuar kriminal në Xxx të të dyshuarve R.D., K.D., G.D. dhe E.S.). Me vendimin e pushimit, edhe masat e sekuestros preventive të përmendura më lart e humbën fuqinë, bazuar në nenin 275 të K.Pr.Penale. Pas humbjes së fuqisë së sekuestros preventive, këto pasuri u vendosën nën sekuestron e caktuar me vendimin e sipërpërmendur të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe edhe aktualisht janë nën këtë masë.

**2.** Me kërkesën objekt gjykimi, Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë,

bazuar në nenet 3, 5, 7, 15 e vijues, 22 e vijues të ligjit nr.10192/2009, ka kërkuar në gjykatë konfiskimin e pasurive të sipërpërmendura, ku për dy apartamentet e banimit të ndodhura në xxx kërkon konfiskimin e tyre pjesërisht, sipas saj vetëm për pjesën që përfaqëson shumën xxx euro që sipas kontratës së porosisë dt.xxx janë paguar efektivisht nga i padituri R.D., ndërsa për apartamentin e banimit të ndodhur në Tiranë, të blerë nga motra e të paditurit R. D., personi i tretë Z.D., u kërkuar konfiskimi tërësisht i tij.

Në kërkesën e saj, nga prokuroria pretendohet se:

-I padituri R.D. është subjekt i veprimit të ligjit nr.10192/2009, pasi është person i dyshuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, sipas nenit 3/1 gërma “d” të këtij ligji. Edhe personi i tretë Z.D., duke qënë motra e të paditurit R.D., përfshihet në rrethin e personave ndaj pasurive të të cilëve zbatohen dispozitat e ligjit nr.10192/2009, bazuar në nenin 3/2 gërma “a” e tij.

-Pasuritë e mësipërme janë krijuar pas vitit xxx, që është koha e kryerjes së aktivitetit kriminal në Xxx nga i padituri R.D. dhe brenda periudhës së kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

-Pasuritë në fjalë janë në zotërim të plotë të personit të mësipërm që është subjekt i ligjit nr.10192/2009.

-Nuk provohet prejardhja e ligjshme e pasurive. I padituri R.D. nuk rezulton të ketë në Shqipëri ndonjë aktivitet tregëtar të rregjistruar ose të ardhura të tjera të ligjshme. Po kështu, edhe nga personi i tretë Z.D. nuk justifikohet dot blerja e pasurisë me aktivitetin privat rrobaqepsi që ka të rregjistruar.

-Megjithëse procedimi penal ndaj të paditurit R.D. është pushuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx për shkak të pamjaftueshmërisë së provave, gjykata, bazuar në nenin 24/2, gërma “a”, nënpika “i” e ligjit nr.10192/2009, mund të vendosë konfiskimin e pasurive.

Por, në pretendimet përfundimtare, prokuroria, bazuar në nenin 201/1 të K.Pr.Civile, hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës (padsë) së saj për konfiskimin e apartamentit të blerë nga Z.D. (me arsyetimin se në gjykim u provua se kjo pasuri ka prejardhje të ligjshme). Për pasojë, **objekt i shqytimit në themel në këtë gjykim mbeti kërkesa e prokurorisë, si më sipër, në lidhje me dy apartamentet e ndodhura në xxx.**

Po kështu, gjatë gjykimit rezultoi se i padituri R.D. dhe shoqëritë “xxx” Sh.p.k. e “xxx” Sh.p.k., me dt.xxx, me anë të një veprimi juridik të emërtuar “revokim kontrate” nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx, kishin revokuar kontratën e porosisë së lidhur mes tyre, duke u përmendur se të paditurit R.D. i kthehet shuma e parave të paguara. Për të njëjtat apartamente dhe me të njëjtën vlerë (xxx euro), këto shoqëri rezultoi se kishin lidhur më pas me shtetasin R.Z. një kontratë për

“prenotim apartamenti” nr.xxx kol., nr.xxx rep, dt.xxx. Në këto rrethana, prokuroria gjatë gjykimit e **shtoi objektin e kërkesës**, duke kërkuar, bazuar në nenin 22/5 të ligjit nr.10192/2009, **edhe konstatimin e pavlefshmërisë së dy veprimeve të mësipërme juridike, përsa i përket vlerës prej xxx euro të paguara nga i padituri R.D.**, si veprime juridike sipas saj të simuluar me qëllim fshehjen e kësaj pasurie (në pretendimet përfundimtare me shkrim nga prokuroria ato referohen si veprime juridike fiktive, që në fakt nuk janë situata juridike të njëjta) dhe për të shmangur konfiskimin e kësaj pasurie.

Nisur nga pretendimet e përfaqësuesit të të paditurit R.D. dhe personit të tretë Z.D. për kontributet e dhëna në krijimin e pasurive objekt gjykimi edhe nga shtetasit F.(F.) D. dhe V. (F.) D., prindërit e të mësipërmeve, si dhe nisur nga ndryshimet dhe shtesat në objektin e kërkesës (padisë) të bëra gjatë gjykimit nga paditësi Prokuroria për Krime të Rënda (ku u ndryshua në konfiskimin e pjesëshëm të dy apartamenteve të ndodhura në xxx, nga tërësisht që ishte në fillim, dhe u shtua me pavlefshmërinë e veprimeve juridike të datës 02.11.2011), gjykata, bazuar në nenin 22/3,4,5 të ligjit nr.10192/2009 dhe në nenet 193, 194 të K.Pr.Civile, thirri në gjykim me cilësinë e personave të tretë edhe shtetasit F.(F.) D. dhe V. (F.) D., si dhe palët e tjera në veprimet juridike që lidheshin me këto dy apartamente, konkretisht shoqëritë “xxx” Sh.p.k., “xxx” Sh.p.k. dhe shtetasin R.Z.

**3.** Në lidhje me kërkesën e prokurorisë, nga ana përfaqësuesit të të paditurit R.D. dhe personave të tretë Z.D., F. (F.) D. dhe V. (F.) D., është parashtruar dhe prapësuar se:

-Ligji nr.10192/2009 nuk gjen zbatim për pasurinë e blerë nga personi tretë Z.D., pasi kjo pasuri është blerë përpara fillimit të aktivitetit kriminal të dyshuar nga ana e të paditurit R.D.. Apartamenti në Tiranë është blerë në muajin xxx, ndërsa nga provat e paraqitura nga prokuroria aktiviteti i dyshuar kriminal i të paditurit R.D. ka filluar rreth tre muaj më pas.

-Familja D. ka qënë në emigracion ekonomik në Xxx duke filluar që prej viteve xxx apo xxx e në vazhdim dhe nga puna kanë siguruar familjarisht, me kontributin e pjesmarrësve të kësaj familje palë në këtë gjykim, të ardhura të mjaftueshme për të blerë apartamentin në Tiranë dhe për të paguar shumën xxx euro për dy apartamentet në xxx. Në llogaritë bankare në emër të personit të tretë F. (F.) D. rezulton shuma rreth xxx euro qysh në vitet xxx-xxx, të ardhura këto të fituara nga puna dhe që nuk janë objekt i këtij ligji. Kjo shumë është e mjaftueshme për të përballuar pasuritë që kërkohen të konfiskohen.

-Kërkimi i paditësit për konfiskimin e dy apartamenteve në xxx në vlerën xxx euro, është i pabazuar në ligj pasi ato nuk kanë qenë dhe as

aktualisht nuk janë pronë e të paditurit R. D. (që ka marrë mbrapsht edhe paratë e paguara për prenotimin e tyre), por e dy shoqërive ndërtuese.

-Lidhja e kontratës nga personi i tretë R.Z. është plotësisht e ligjshme dhe nuk plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 22/5 të ligjit nr.10192/2009 për konstatimin e pavlefshmërisë së tyre.

Edhe nga përfaqësuesi i personit të tretë R.Z. u parashtruan të njëjtat prapësime si më sipër në lidhje me kontratën e lidhur mes këtij personi të tretë dhe shoqërive “xxx” Sh.p.k. e “xxx” Sh.p.k.

**4.** Gjykata, për sa i përket kërkesës (padsisë) së Prokurorisë për konfiskimin e apartamentit të blerë nga personi i tretë Z.D., bazuar në nenet 201/1 dhe 299/b të K.Pr.Civile duhet të vendosë **pushimin i gjykimit për këtë pjesë**, për shkak se paditësi hoqi dorë nga gjykimi i saj.

**5.** Në lidhje me pjesën tjetër të kërkesës (padsisë), gjykata vlerëson sa më poshtë:

Ligji nr.10192/2009 drejtohet kundër pasurive të personave të dyshuar për përfshirje në veprimtaritë kriminale të përcaktuara në këtë ligj, që janë vepra penale të sferës së krimit të organizuar dhe trafikimit dhe qëllimi i tij është që të parandalohet dhe goditet ky lloj kriminaliteti me anë të masave parandaluese të marra ndaj pasurive të personave të dyshuar, ku më kryesorja është konfiskimi i tyre. Për të vendosur konfiskimin e pasurisë së personit të dyshuar, bazuar në nenin 24/1 të ligjit nr.10192/2009, duhet të plotësohen njëkohësisht këto kushte:

*“a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;*

*b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre;*

*c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit.”*

Bazuar në nenin 21/3 të ligjit nr.10192/2009, barra e provës për të vertetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme i takon personit kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi.

**5.1.** Në rastin në gjykim, i padituri R.D. është person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Në nenin 3/1 gërma “d” e ligjit nr.10192/2009 parashikohet:

*“1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për:*

*...d) kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet ... 287 të Kodit Penal”.*

Sipas kësaj dispozite, për vertetimin e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen



e veprave penale që parashikohen në të, është e mjaftueshme që shkalla e provueshmërisë të jetë në nivelin e indicieve (dhe më shumë se një). Barra e të provuarit të këtij kushti i takon prokurorit.

Në këtë kontekst, në rastin në gjykim rezulton se ndaj të paditurit R.D. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx kishte filluar procedimin penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Dyshimi, sipas nenit 3/1 gërma “d” të ligjit nr.10192/2009, për kryerjen e kësaj vepre penale nuk ngrihet thjesht nga informacioni (shkresa) për referimin e veprës penale nga policia gjyqësore dhe rregjistrimi mbi këtë bazë i një procedimi penal nga ana e prokurorisë përkatëse, por rrjedh nga fakti objektiv se ndaj këtij shtetasi në shtetin xxx po kryen hetime penale pasi dyshohet se së bashku me persona të tjerë, shtetas shqiptarë, ka kryer një sërë vjedhjesh me armë dhe me dhunë të disa supermarketeve dhe dyqaneve në këtë vend dhe vlera e parave të vjedhura arrin në shuma të mëdha (në total rreth një milion euro). Ky fakt vertetohet në gjykim nga kërkesa për ndihmë juridike me nr.09222/834, dt.16.01.2012 e autoriteteve gjyqësore xxx (hetuesi i Seksionit Hetimor nr.16 të Gjykatës së Shkallës së Parë xxx), me anë të së cilës këto autoritete kërkojnë informacion për vendimet e marra në Shqipëri për bllokimin e pasurive të personave të sipërpërmendur të dyshuar për kryerjen e veprave penale në xxx. Në këtë letërporosi, midis të tjerave përmendet:

*“...me kërkesë të Prokurorit pranë Gjykatës së Kundravajtjeve Penale të Shkallës së Parë xxx, Nr. xxx prot., është ushtruar ndjekje penale ndaj shtetasve R.D., i biri i V. dhe i F., 2) K.D....3) G. ose G.D. ose A.... 4) E.S...., të cilët akuzohen për 1) krijim organizate kriminale 2) vjedhje me dhunë në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, tentativë vjedhjeje me fytyrë të mbuluar 3) armëmbajtje 4) zotërim arme 5) të shtëna në ajër 6) vjedhje në bashkëpunim 7) falsifikim 8) shkelje të nenit 87 pg.7 të ligjit 3386/2005 dhe 9) legjitimim të ardhurash nga veprimtaria kriminale dhe në mënyrë të veçantë nga veprimtaria e organizatës kriminale dhe nga një sërë vjedhjesh me dhunë... . Personat si më sipër akuzohen se gjatë një periudhe kohore prej rreth tre vjetësh, në një datë që nuk u arrit të saktësohej gjatë fazës së hetimeve, por padyshim brenda harkut kohor nga fund i vitit xxx deri në dt.xxx pra, **para fillimit të aktivitetit kriminal më xxx** krijuan një grup të strukturuar kriminal, me ndarje detyrash, me aktivitet të vazhdueshëm, me anëtarë të alternuar që synonin gjithmonë të vepronin si grup duke pasur si qëllim kryerjen e sa më shumë vjedhjeve me dhunë. Më konkretisht, të akuzuarit si më sipër, të furnizuar më armët e duhura, me materialet e maskimit (xhokej, paruke, uniforma dhe kapele me stampat e supermarketeve “xxx” dhe “xxx” dhe me automjete për t’u larguar sa më shpejt nga vendi i ngjarjes, piketonin objektin ku do të kryenin vjedhjen, i bënë autopsinë, caktonin mënyrën e organizimit dhe të veprimit duke operuar gjithmonë në ditë dhe orë të caktuara gjatë dorëzimit të xhiros ditore tek shoqëritë e ngarkuara me transportimin e parave. R.D. ishte ai dhe i vetmi që hynte gjithmonë brenda dyqaneve me fytyrë të mbuluar dhe, nën kërcënimin e armës, i detyronte punonjësit t’i dorëzonin paratë, kurse të tjerët qëndronin jashtë si roje apo të gatshëm për të vepruar e për t’i ardhur në ndihmë gjatë largimit nga vendi i ngjarjes. Në këtë mënyrë, të pandehurit si më sipër kanë kryer 23 (njëzet e tre) vjedhje me dhunë gjatë të cilave kanë vjedhur nga supermarketet më shumë se xxx Euro. Në tri raste, gjatë largimit nga vendi i ngjarjes, i*

*pandehuri i parë ka qëlluar me revolver në ajër, për të krijuar panik. Përveç sa më sipër, të pandehurit kishin vjedhur dhe një motoçikletë. Gjatë kontrollit të banesës së të pandehurit të parë dhe të katërt u gjetën: një armë zjarri e tipit kallashnikov, pistoleta, krëhëra fishekësh, fishekë dhe një thikë. Gjatë kontrollit të banesës së të pandehurit të parë dhe të katërt u gjetën gjithashtu dokumenta fallco (leje drejtimi automjetesh, pasaporta) që i mbanin për t'i përdorur për qëllim mashtrimi duke kryer dhe një akt tjetër të kundraligjshëm, ndërsa i katërti u kap me dokument udhëtimi original të një personi tjetër. Së fundi, të pandehurit, nga njëra anë, për të fshehur prejardhjen e paligjshme të parave si më sipër, i kthyen ato në pasuri duke e zotëruar, administruar apo përdorur këtë pasuri ndërkohë që e dinin se kjo pasuri ishte produkt i aktivitetit kriminal si më sipër dhe, nga ana tjetër, përdorën sistemin financiar duke i depozituar apo qarkulluar paratë nga aktiviteti kriminal, për t'u dukur ato si të ligjshme... ”.*

Po kështu, lidhur me ekzistencën e dyshimeve të bazuar në indicie për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, rezulton se i padituri R.D. ka lidhur kontratën e porosisë të përmendur më lart për ndërtimin e dy apartamenteve në qytetin e xxx dhe ka paguar paraprakisht këstin e parë në shumën xxx euro.

Në këto kushte, në ngarkim të të paditurit R.D. gjykata vlerëson se përmbushet kërkesa ligjore për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm **të bazuar në indicie** për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal dhe për pasojë, sipas nenit 3/1 gërma “d” e ligjit nr.10192/2009, ai është subjekt i zbatimit të këtij ligji dhe pasuritë e tij janë objekt i masave parandaluese që parashikohen në të.

Për shkak lidhjes së afërt të gjinisë të personit të tretë Z.D. me të paditurin R.D. (motra e tij) dhe faktit se në emër të saj figuronte pronësia e apartamentit të banimit në qytetin e xxx, sipas kontratës së shitjes nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx, edhe kjo shtetase përfshihej në rrethin e personave ndaj pasurive të të cilëve zbatohen dispozitat e ligjit nr.10192/2009, bazuar kjo në nenin 3/2 gërma “a” të këtij ligji.

Nga ana tjetër, pushimi i çështjes penale ndaj të paditurit R.D. nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx për veprën penale të mësipërme, nuk pengon zbatimin e masave parandaluese të parashikuara nga ligji nr.10192/2009, kjo pasi neni 24/2 gërma “a”, nënpika “i” e tij, parashikon si vijon: “2. Gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj personit pushohet nga organi procedues për shkak: i) të pamjaftueshmërisë së provave; ...”.

**5.2.** Gjykata, për sa i përket “objektit” të kërimit të Prokurorisë (dalluar nga “shkaku ligjor”), ku kërkohet “konfiskimi pjesërisht, për pjesën që përfaqëson shumën xxx euro, i dy apartamenteve të ndodhura në xxx”, vlerëson se ai nuk është i bazuar.

Nga provat e marra në gjykim rezultoi vetëm se i padituri R.D., me dt.xxx, ka lidhur një kontratë porosie për ndërtimin e këtyre apartamenteve, me vlerë totale xxx euro dhe se në zbatim të detyrimeve të

kontratës ai ka paguar vetëm një shumë prej xxx euro që përbënte këstin e parë të pagesës së vlerës së apartamenteve. Megjithëse rezulton se ndërtimi i apartamenteve ka përfunduar (si pjesë e kompleksit përkatës të banimit të ndërtuar nga shoqëritë persona të tretë), i padituri R.D. nuk rezulton që të ketë kryer pagesa të tjera në zbatim të kontratës së porosisë dhe në vijim nuk rezulton as që ato (apartamentet) t'i jenë dorëzuar të paditurit porositës R.D. Nga ana tjetër, nuk rezulton që këto apartamente të jenë të regjistruara si pasuri të paluajtshme në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxx, fakt ky që pranohet edhe nga vetë paditësi Prokuroria për Krime të Rënda. Ndodhur në këto kushte, gjykata vlerëson se paditësi nuk mund të kërkojë drejtëpërdrejt konfiskimin e një prone të paluajtshme për të cilën i padituri R.D. nuk rezulton të ketë fituar ndonjë të drejtë për zotërimin e saj, por bazuar në ligjin nr.10192/2009 duhet të kërkonte vetëm konfiskimin e shumës prej xxx euro që rezulton se janë zotëruar efektivisht dhe paguar prej të paditurit R.D. në kohën e lidhjes së kontratës së porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx.

Pikërisht për të bërë të mundur ekzekutimin e një vendimi të mundshëm në favor të konfiskimit të kësaj shume, do të shërbente edhe masa e sekuestrimit të këtyre apartamenteve e vendosur nga kjo gjykatë sipas nenit 11 të ligjit nr.10192/2009, me vendimin nr.7, dt.14.10.2011. Mënyra e nxjerrjes së kësaj shume nga vlera e apartamenteve të sekuestruara do t'i mbetej fazës së ekzekutimit të vendimit të mundshëm të konfiskimit.

Ndodhur në të njëjtat kushte të përmendura më lart, një mënyrë tjetër për të ndjekur pasurinë dhe ekzekutuar një vendim të mundshëm konfiskimi të shumës prej xxx euro, do të kishte qënë edhe sekuestrimi i kësaj shume ose i pasurisë në të cilën ajo mund të ishte konvertuar, pranë personave të tretë në këtë gjykim, të cilëve rezulton se u është paguar kjo shumë nga i padituri R.D.

Siç përcaktohet nga përmbajtja e neneve 5, 6, 16/1, 28 dhe 185 të K.Pr.Civile, padia disponohet prej paditësit dhe gjykata nuk mund të ndryshojë vetë as objektin dhe as shkakun ligjor të padisë. Prandaj, **vetëm përsa i përket “objektit” të kërkesës** së ngritur nga Prokuroria për Krime të Rënda, gjykata, me argumentimin e mësipërm, vlerëson se **ajo nuk mund të ngrihej në këtë formë.**

Si pasojë e përfundimit të mësipërm (i cili në çdo rast qëndron më vete), rrjedh edhe konkluzioni tjetër se, **mbi këtë objekt kërkimi**, konfiskimi nuk mund të pranohet pasi **nuk përmbushet në këtë rast kushti i përcaktuar në pikën “c”** të nenit 24/1 të ligjit nr.10192/2009, që kërkon që pasuria (apartamentet) të jetë drejtëpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit.

**5.3.** Megjithatë, duke u nisur nga fryma dhe qëllimi i ligjit nr.10192/2009 (i përmendur më lart në fillim të pikës 5 të arsyetimit), ku duhet nënvizuar se ai

ndjek pasuritë e personave për veprimtaritë e dyshuara kriminale (dhe atyre të lidhur me ta) pavarësisht trajtës dhe formës që ato mund të kenë marrë dhe lidhur me këtë, nisur nga shkaku ligjor i kërkesës objekt gjykimi, si dhe duke patur parasysh edhe parashikimin e nenit 5/2 të këtij ligji sipas të cilit: *“Verifikimet, hetimet dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile”*, gjykata çmon që të marrë në shqyrtim edhe në themel **bazueshmërinë e pretendimit të palës paditëse në lidhje me shumën xxx euro që vertetohet se ka qënë në zotërim të të paditurit R.D., prej nga rrjedh edhe kërkimi i paditësit për konfiskimin pjesërisht të dy apartamenteve të ndodhura në xxx.**

Kështu, në rastin në gjykim, siç u arsyetua edhe më lart në këtë vendim, për shumën xxx euro rezulton se plotësohen kushtet e parashikuara në pikat “a” dhe “c” të nenit 24/1 të ligjit nr.10192/2009, kurse për sa i përket kushtit të përcaktuar në pikën “b” të këtij neni, që bën fjalë për justifikimin e krijimit të pasurisë më të ardhura të fituara në rrugë të ligjshme, në këtë gjykim rezultoi sa më poshtë:

Nga ana e përfaqësuesit të të paditurit R.D. dhe personave të tretë Z.D. V.D. dhe F.D., në gjykim është parashtruar se pasuritë objekt gjykimi, përfshirë edhe apartamentin e blerë nga personi i tretë Z.D. për të cilin prokurori hoqi dorë nga gjykimi, janë krijuar me të ardhurat e përbashkëta familjare nga puna në emigracion në xxx e këtyre personave pjesëmarrës si palë në gjykim, me të ardhurat nga aktiviteti privat në Shqipëri i personit të tretë Z.D., me të ardhurat nga toka bujqësore dhe rrënjët e ullinjve të familjes D. të ndodhura në xxx dhe me kredinë e marrë nga personi i tretë Z.D. në bankën xxx.

Kështu, nga çertifikata familjare e familjes D., me nr.xxx, dt.xxx, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile xxx dhe nga pasaporta për jashtë shtetit nr.xxx, dt.lëshimi xxx e F.D. (ku ndodhen të shënuar fëmijët e mitur në ngarkim të saj në kohën e lëshimit të pasaportës), rezulton se kjo familje përbëhet nga prindërit F. dhe F.D. dhe shtatë fëmijë: V. (dtl.xxx), E. (dtl.xxx), A. (dtl.xxx), A.(dtl.xxx), Z. (dtl.xxx), G.(dtl.xxx) dhe Zh. (dtl.xxx).

Nga çertifikata familjare nr.xxx, dt.xxx e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Njësisë Bashkiake nr.x, xxx dhe çertifikatat personale nr.xxx, dt.xxx dhe nr.xxx, dt.xxx të lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile xxx, vertetohet se të paditurit R.D. dhe personat e tretë F.D. e V.D. kanë bërë ndryshimin e emrave që kanë patur më parë, konkretisht nga “A.” në “R.”, nga “F.” në “F.” dhe nga “F.” në “V.”.

Nga provat e marra në gjykim, rezultoi se i padituri R.D. dhe

personat e tretë V.D. dhe F.D. kanë qënë në emigracion në xxx prej shumë vitesh.

I padituri R.D. rezulton se është pajisur nga organet e policisë xxx me “kartë identiteti” nr.xxx, e vlefshme për periudhën xxx deri më xxx (me emrin e mëparshëm A.D.). Po kështu, ky i paditur rezulton se është pajisur nga Bashkia xxx me “vertetimin” nr.prot xxx, dt.lëshimi xxx, me afat deri më dt.xxx, e vlefshme deri në marrjen e lejes definitive të qëndrimit në xxx.

Nga pasaportat për jashtë shtetit me nr.xxx, dt.lëshimi xxx dhe nr.xxx, dt.lëshimi xxx të personit të tretë F.D. dhe pasaportat për jashtë shtetit nr.xxx, dt.lëshimi xxx dhe nr.xxx, dt.lëshimi xxx të personit të tretë V.D., rezulton se këta persona të tretë janë pajisur me disa viza hyrje për në shtetin xxx, duke filluar prej datës xxx e në vazhdim për personin e tretë F.D. dhe prej datës xxx e në vazhdim për personin e tretë V.D.. Duhet theksuar se në pasaportën për jashtë shtetit nr.xxx, dt.lëshimi xxx të personit të tretë F.D., ndodhen të shënuar edhe fëmijët e mitur në atë kohë në ngarkim të saj, konkretisht Z.D., G.D. dhe Zh.D..

Gjithashtu, rezulton se personi i tretë F.D. është pajisur në shtetin xxx edhe me “kartë speciale identiteti homogjeni xxx” nr.xxx, lëshuar nga organet e policisë xxx, e vlefshme për periudhën xxx-xxx.

Nga përfaqësuesi i të paditurit R.D. dhe i personave të tretë Z.D., V.D. dhe F.D., janë paraqitur si prova në gjykim edhe deklarata të dy shtetasve xxx, konkretisht deklaratë përgjegjësie e lëshuar nga E.P. dt.xxx dhe deklaratë përgjegjësie e lëshuar nga E.P. dt.xxx, të bëra përpara organeve të policisë xxx të xxx sipas legjilacionit përkatës të shtetit xxx dhe të legalizuara nga zyra konsullore e Ambasadës Shqiptare në xxx. Në deklaratën e shtetasit E.P., thuhet se personi tretë V.D. ka qënë i punësuar në sipërmarrjen e këtij shtetasi si ndërtues, në vitet xxx-xxx, me pagë të rregullt xxx euro, ndërsa në deklaratën e shtetasit E.P. thuhet se personi i tretë F.D. ka qënë punësuar si ndihmëse shtëpiake në shtëpinë e saj në xxx (më adresë të treguar në deklaratë) në vitet xxx-xxx. Ndryshe nga pretendimi prokurorisë, gjykata thekson se legalizimi i tyre nga përfaqësia diplomatike e vendit tonë në xxx, me qëllim përdorimin e tyre në Shqipëri, është e njëvlefshme me vertetimin “apostille” sipas Konventës së Hagës së datës 5 Tetor 1961. Madje ky i fundit (vertetimi “apostille”) përdoret pikërisht për të lehtësuar dhe uniformizuar procedurat e legalizimit pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore përkatëse të dokumentave zyrtare për përdorim jashtë shtetit, për vendet që e kanë ratifikuar Konventën e mësipërme të Hagës.

Në vetvete këto deklarata gjykata i çmon se nuk janë prova të

mjaftueshme për të vertetuar drejtëpërdrejt dhe të vetme sa kërkon gërma “b” e nenit 24/1 të ligjit nr.10192/2009, pra për të vertetuar ligjshmërinë e prejardhjes së pasurisë pikërisht për vlerat e parave që përmenden në to, pasi ato kanë fuqinë provuese vetëm të një shkrese të thjeshtë sipas neneve 258, 259 të K.Pr.Civile, që do të thotë se ato përbëjnë prova vetëm për faktin se deklaratimet që përmbajnë janë të atyre që i kanë nënshkruar.

Por, gjykata të dhënat që pasyrohen në këto deklarata në lidhje me faktin dhe periudhën e qënies në emigracion në shtetin xxx dhe të punësimit atje, i vlerëson të lidhura edhe me sa rezulton nga dokumentat e identitetit dhe lejet e qëndrimit të lëshuara në xxx dhe pasaportat me vizat xxx për të paditurin R.D. dhe personat e tretë F.D. e V.D.. Në këto rrethana, gjykata vlerëson se vertetohet fakti i qënies në emigracion në xxx që prej viteve xxx-xxx të pjestarëve të familjes D., konkretisht të personave të tretë V.D. dhe F.D. dhe të paditurit R.D., përfshirë këtu edhe fëmijët e mitur në atë kohë që figurojnë në pasaportën për jashtë shtetit të F.D. të vitit xxx, konkretisht Z.D., G.D. dhe Zh.D..

Nga ana tjetër, nga të dhënat e marra me dt.xxx nga Banka xxx, të pasqyruara në dokumentin me titull “Lëvizje e llogarive Retial për një NRP”, rezulton se personi i tretë F. (F.) D. ka patur në depozita kursimi shuma të ndryshme parash, në lekë dhe në euro. Megjithëse nga dokumenti i mësipërm del se personi i tretë F.D. ka kryer lëvizje të ndryshme (depozitime dhe tërheqje) me depozitat e kursimit dhe për këtë shkak në disa raste nuk mund të konkludohet me siguri nëse në to janë përfshirë ose jo të njëjtat shuma që kanë qënë të depozituara më parë, më së paku **vertetohet** me siguri se në **xxx (xxx)** ajo ka depozituar në depozitë kursimi shumën prej **xxx (xxx) euro**, të cilën e ka tërhequr më pas me dt.xxx (fq.1-2 e dokumentit), ndërsa në **xxx (xxx)** ajo ka depozituar shumën **xxx (xxx) euro**, e përbërë kjo nga dy shuma të depozituara në këtë datë prej xxx eurosh dhe xxx eurosh, të cilën e ka tërhequr tërësisht më pas me dt.xxx (fq.x e dokumentit). Në të dy këto raste, personi i tretë F.D. nuk ka patur depozita të tjera në këtë bankë dhe nuk ka kryer lëvizje të tjera (derdhje apo tërheqje) me këto depozita, prandaj mund të **konkludohet me siguri ekzistenca dhe zotërimi i këtyre shumave prej personit të tretë F.D. në periudhat e mësipërme.**

Siç shihet, kjo shumë parash (në fillim xxx euro dhe më pas e rritur në xxx euro) vertetohet se **është zotëruar prej personit të tretë F.D. përpara fillimit të aktivitetit të dyshuar kriminal** (vjedhjeve) në xxx nga ana të paditurit R.D., që, sikurse u përmend më lart, nga **vetë autoritetet gjyqësore xxxe është referuar si data xxx dhe lidhur me këtë, të përfshirjes së tij në veprimtarinë e pastrimit të produkteve të këtyre veprave penale**, për të cilën ai dyshohet dhe është bërë subjekt i zbatimit të ligjit nr.10192/2009 (madje shuma prej xxx euro është zotëruar edhe përpara fundit të vitit xxx që përmendet nga autoritetet gjyqësore xxx si periudha kur dyshohet se kanë filluar përgatitjet për kryerjen e veprimtarive kriminale nga i padituri dhe personat e

tjerë, megjithëse del se deri me dt.xxx ata nuk kishin kryer ndonjë vjedhje).

Fakti i disponimit të kësaj pasurie nga ana e personit të tretë F.D. në fund të vitit xxx dhe në fillim të vitit xxx, nga ana tjetër vjen në përputhje me të dhënat që rezultojnë më lart, të pranuar nga gjykata, në lidhje me qënien në emigracion në shtetin xxx, duke filluar nga periudha e përmendur në paragrafet e mësipërm, të të paditurit R.D. dhe personave të tretë F.D., V.D. dhe Z.D. dhe nxjerrjes së të ardhurave nga puna në emigracion atje.

Siç u tha më lart, prokurori hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës për konfiskimin e apartamentit të blerë në xxx nga personi i tretë Z.D., duke pranuar se në gjykim u provua prejardhja e ligjshme e kësaj pasurie. Megjithatë duhet përmendur se neni 3/4 i ligjit nr.10192/2009, parashikon se *“ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji”*. Pra, sipas kësaj dispozite, fusha e zbatimit të këtij ligji nuk shtrihet për pasuritë e krijuara përpara përfshirjes së dyshuar në veprimtarinë kriminale nga personi konkret. Apartamenti në xxx në emër të personit të tretë Z.D., rezulton se është blerë prej saj **përpara përfshirjes së dyshuar të të paditurit R.D. në aktivitetin kriminal në xxx dhe lidhur me këtë, të përfshirjes së tij në veprimtarinë e pastrimit të produkteve të këtyre veprave penale**, për të cilën ai dyshohet dhe është bërë subjekt i zbatimit të ligjit nr.10192/2009. Siç rezulton nga kontrata e shitjes nr.xxx rep., nr.xxx kol.,dt.xxx, data e saj është **3-4 muaj përpara datës xxx** kur ka filluar aktiviteti i dyshuar kriminal në xxx i të paditurit R.D.. Për këtë arsye **ndaj kësaj pasurie nuk mund të zbatohet ligji nr.10192/2009.**

E njëjta situatë, bazuar në nenin 3/4 të ligjit nr.10192/2009, është edhe për shumën prej xxx euro në vitin xxx e rritur në xxx euro në xxx xxx, që figuron në emër të personit të tretë F.D. siç u përmend më lart. Prandaj, **edhe kjo pasuri është jashtë fushës së zbatimit të ligjit nr.10192/2009.**

Megjithatë, nisur nga kërkimi i prokurorisë që lidhet me vlerën prej xxx euro të paguara për dy apartamentet e ndodhura në xxx, gjykata çmon se pasuritë e sipërpërmendura, pra shuma xxx euro e disponuar nga F.D. në vitin xxx apo xxx euro e disponuar prej saj në xxx xxx dhe apartamenti i blerë nga Z.D. në vlerën xxx lekë në xxx xxx, nuk mund të përjashtohen (si të ardhura dhe shpenzime) nga vlerësimi që duhet të bëhet për justifikimin e krijimit në rrugë të ligjshme, deri me dt.xxx kur është lidhur kontrata e porosisë, të vlerës prej xxx euro nga ana e pjestarëve të familjes D. palë në këtë gjykim.

Kështu, diferenca mes shumës xxx euro që ka patur në depozitë bankare në xxx xxx personi i tretë F.D. dhe vlerës prej xxx lekë ose **xxx euro** të apartamentit të blerë nga personi i tretë Z.D. me dt.xxx (konvertimi me kursin e këmbimit të kohës ndodhet në fq.xx të aktit të ekspertimit kontabël që do të përmendet në vijim), rezulton të jetë në shumën xxx euro, ndërsa duke marrë për bazë gjendjen e depozitës bankare të F.D. në xxx xxx, xxx euro, diferenca me vlerën e apartamentit është në shumën **xxx euro.**

Në të vërtetë, rezulton se personi i tretë F.D. të gjithë shumën prej xxx euro të depozituar në bankë e ka tërhequr me dt.xxx, pra disa ditë përpara blerjes së apartamentit nga ana e personit të tretë Z.D. (dt.xxx) dhe ky fakt është plotësisht në funksion të vertetimit të rrethanës se apartamenti në emër të personit të tretë Z.D. është blerë me kontributin dhe të ardhurat e përbashkëta të palëve në këtë gjykim R.D., F.D., V.D. dhe Z.D.

Nga sa më sipër, duke qenë se mbetja në fjalë është në shumën xxx euro, rezulton se nga të ardhurat e përbashkëta të këtyre palëve ka qënë plotësisht e mundur përballimi jo vetëm i vlerës së apartamentit të blerë nga personi i tretë Z.D., por edhe i shumës prej xxx euro të paguara në vitin xxx nga i padituri R.D. për ndërtimin e dy apartamenteve në xxx, sipas kontratës së porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx.

Përveç sa më sipër, nga ana e gjykatës, me kërkesë edhe të paditësit, u krye një ekspertim kontabël për të vlerësuar kursimet e mundshme të pjestarëve të familjes D. palë në gjykim dhe personave në ngarkim të saj, për të gjithë periudhën e qënies në emigracion në shtetin xxx. Nga ekspertimi kontabël i kryer nga eksperti kontabël Gj.H., i depozituar në gjykatë me dt.xxx (pas plotësimit), rezultoi se kursimet e familjes D., duke marrë për bazë jo pagën e treguar në deklaratat e shtetasve xxxë të përmendur më lart, por pagën minimale zyrtare të shtetit xxx në vitet përkatëse (sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga EUROSTAT) dhe nga ana tjetër shpenzimet për jetesë në shtetin xxx (sipas të dhënave të EL.STAT të shtetit xxx), duke filluar nga viti xxx-xxx e deri me dt.xxx kur është lidhur kontrata e porosisë arrijnë në shumën xxx (xxx) euro (fq.xx-xx e aktit të ekspertimit).

Në vlerësimin e bërë nga eksperti, për familjen D. janë marrë parasysh si persona që sjellin të ardhura palët në këtë gjykim dhe për të cilët më sipër u vertetua me dokumenta se kanë qënë në emigracion ekonomik në xxx, i padituri R.D. dhe personat e tretë F.D. dhe V.D., ndërsa si persona në ngarkim të familjes janë marrë parasysh tre të mësipërmit si dhe fëmijët e mitur (të përmendur më lart në vendim) që figurojnë në pasaportën për jashtë shtetit të F.D., deri kur këta kanë arritur në moshë madhore. Për fëmijët e tjerë madhore për të cilët në gjykim nuk u vertetua me dokumenta që të kenë qënë në shtetin xxx dhe të kenë sjellë të ardhura, eksperti me të drejtë nuk i ka llogaritur as në krijimin e të ardhurave dhe as në ngarkesën e familjes D. në xxx. Për këta, si persona që kanë sjellë të ardhura, nuk është pretenduar në gjykim as nga përfaqësuesi i të paditurit dhe personave të tretë dhe për këtë shkak ata nuk janë thirrur as si palë në gjykim (teorikisht, në rast të përfshirjes edhe të fëmijëve të tjerë madhorë si kontribues në të ardhurat e siguruara nga emigracioni në xxx, rezultati do të ishte edhe më i lartë se shuma e mësipërme). (Nga ekspertimi është arritur në përfundimin se edhe duke marrë për bazë si periudhë fillimi datën e vizave më të hershme për në shtetin xxx, të përmendur më lart në vendim, shuma e mundshme e kursimit deri me dt.xxx arrin në shumën xxx euro - fq.xx, xx e aktit të ekspertimit).



**Edhe nga konkluzioni i mësipërm i ekspertimit kontabël për kursimin në shumën 86.826 euro, rezulton se me të ardhurat e përbashkëta ka qënë plotësisht e mundur mbulimi i vlerës së apartamentit të blerë në xxx në xxx nga personi i tretë Z.D. dhe pagesës së këstit prej xxx euro në xxx xxx nga i padituri R.D. për ndërtimin e dy apartamenteve në xxx.**

Nga ana e ekspertit kontabël është bërë edhe një vlerësim i të ardhurave të mundshme të nxjerra nga familja D. prej 40 rrënjëve ullinj që sipas vertetimit dt.xxx të Bashkisë xxx, u janë dhënë atyre në përdorim sipas ligjit nr.7501/1991 (së bashku me xxx m<sup>2</sup> tokë bujqësore). Sipas ekspertit, të ardhurat e mundshme për të gjithë periudhën e vlerësimit arrijnë në shumën xxx (xxx) euro (fq.xx e aktit të ekspertimit kontabël). Megjithatë, gjykata vlerëson se nuk ka bazë që këtë shumë ta përfshijë në të ardhurat e familjes D. për arsye se më lart është pranuar nga gjykata, por njëlloj është pretenduar edhe nga vetë përfaqësuesi i të paditurit dhe personave të tretë D., se këto palë kanë qënë në shtetin xxx ku edhe kanë nxjerrë të ardhura dhe jo në Shqipëri.

Nga ana e përfaqësuesit të personit të tretë Z.D. janë paraqitur si prova edhe një kontratë kredie bankare të lidhur mes xxx Bank dhe personit të tretë Z.D., dt.xxx, sipas të cilës rezulton se ajo në këtë datë ka marrë kredi në shumën xxx (xxx) lekë (me përshkrimin financim investimi). Po kështu ai ka paraqitur si prova edhe vendimin nr.xxx, dt.xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx për regjistrimin e saj si person fizik në aktivitetin privat të rrobaqepsisë, si dhe një ekstrakt të regjistrimit tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, dt.xxx, për të dhënat e subjektit Z.D. si person fizik, me objekt të veprimtarisë (të ndryshuar) tregëti e artikujve industrialë. Në lidhje me të dhënat që rezultojnë nga këto dokumenta, gjykata konstaton se përsa i përket aktivitet privat të personit të tretë Z.D., nuk rezulton nëse ka nxjerrë të ardhura prej tij dhe sasia e tyre, prandaj ato nuk ndikojnë në rezultatin e mësipërm të kursimit. Për sa i përket shumës së kredisë (e konvertuar në vlerën **xxx euro** sipas aktit të ekspertimit kontabël, fq.xx), ajo rezulton se është marrë me dt.xxx, disa ditë përpara lidhjes së kontratës së porosisë nga i padituri R.D., që mban datën xxx dhe për këtë shkak **ajo merret në konsideratë nga gjykata** edhe në vlerësimin e shumës totale të burimeve që mund të justifikohen në këtë gjykim nga ana e të paditurit R.D. dhe personave të tretë Z.D., F.D., V.D., në lidhje me pagimin e shumës prej xxx eurosh për lidhjen e kontratës së porosisë.

**Si konkluzion,** gjykata krijon bindje dhe arrin në përfundimin se në përputhje me kërkesat e nenit 21/3 të ligjit nr.10192/2009, **i padituri R.D. dhe personat e tretë Z.D., F.D. dhe V.D. arritën të provojnë dhe të justifikojnë plotësisht prejardhjen e ligjshme të shumës prej xxx euro të paguar prej të paditurit R.D. sipas kontratës së porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx.** Për pasojë, gjykata konkludon se **nuk plotësohet një nga tre kushtet e pranimit të konfiskimit, konkretisht ai i përcaktuar në gërmën “b” të nenit 24/1 të ligjit nr.10192/2009,** të cituar më lart në vendim.

**6.** Sikurse është përmendur edhe në fillim të arsyetimit të këtij vendimi, i

padituri R.D. dhe personat e tretë shoqëritë “xxx” Sh.p.k. e “xxx” Sh.p.k, me dt.xxx, kanë revokuar kontratën e porosisë së lidhur mes tyre për ndërtimin e dy apartamenteve në xxx, me veprimin juridik “revokim kontrate” me nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx dhe këta persona të tretë i kanë kthyer të paditurit R.D. shumën prej xxx euro që kishte paguar. Më pas, për të njëjtat apartamente dhe me të njëjtën vlerë prej xxx euro, këto shoqëri kanë lidhur me personin e tretë R.Z. kontratën për “prenotim apartamenti” nr.xxx kol., nr.xxx rep., dt.xxx. Personi i tretë R.Z. me lidhjen e kësaj kontrate ka paguar po me dt.xxx dy këstet e para, në shumën totale xxx (xxx) euro, siç rezulton nga dy dokumentat për derdhjet e shumave xxx euro dhe xxx euro nga personi i tretë R.Z. në Bankën Kombëtare Tregëtare xxx, dt.xxx, të administruara si prova në gjykim.

Për këto veprime juridike prokuroria ka kërkuar që të konstatohet pavlefshmëria e tyre përsa i përket vlerës prej 45.000 euro të paguara nga i padituri R.D., bazuar në nenin 22/5 të ligjit nr.10192/2009, sikurse është përmendur në fillim të këtij vendimi.

Neni 22/5 i ligjit nr.10192/2009 konkretisht parashikon:

*“Kur vërtetohet se disa pasuri i janë transferuar apo janë regjistruar në emër të të tretëve, me veprime juridike fiktive ose të simuluar, gjykata konstaton pavlefshmërinë e këtyre veprimeve juridike. Për këtë qëllim, kur nuk provohet e kundërta, prezumohen fiktive ose të simuluar edhe:*

*a) transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull barrësor, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese kundër personave të afërm;*

*b) transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull falas apo dukshëm nën vlerën e tregut, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese”.*

Në lidhje me këtë kërkim të prokurorisë, gjykata vlerëson sa më poshtë:

Së pari, më sipër në këtë vendim u arrit në përfundimin se nga i padituri R.D. dhe personat e tretë D. u justifikua ligjshmëria e prejardhjes së shumës prej xxx euro të paguar nga i padituri R.D. për kontratën e porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx. Në këto kushte, janë të pabazuara të gjitha kërkimet e tjera që rrjedhin nga kërkesa për konfiskimin e të njëjtave pasuri të paraqitur sipas neneve 21 e 24 të ligjit nr.10192/2009 dhe që për shkakun e mësipërm nuk u gjet e bazuar nga gjykata.

Së dyti, pavarësisht nga sa më sipër, gjykata vëren se me provat e paraqituara dhe të shqyrtuara në këtë gjykim, nuk është provuar ndonjë lidhje gjinie apo krushqie e afërt (apo edhe e largët) apo çdo lloj lidhje tjetër konkrete nga ato që parashikon neni 3/2 gërma “b” e ligjit nr.10192/2009, mes të paditurit R.D. dhe personit të tretë R.Z., në mënyrë që të konkludohet se apartamentet, pavarësisht kontratës për prenotim apartamenti nr.xxx kol., nr.xxx rep., dt.xxx të lidhur nga personi i tretë R.Z., janë në të vërtetë në zotërimin e tërthortë (të plotë ose të pjesshëm) të të paditurit R.D.

Po kështu, së treti, në rastin e kontratës për prenotim apartamenti nr.xxx

kol., nr.xxx rep., dt.xxx, nuk vertetohet as ndonjë nga rrethanat faktike që sipas nenit 22/5 të ligjit nr.10192/2009 çon në prezumimin për një veprim juridik fiktiv (pa patur qëllim të krijojnë pasoja juridike) ose të simuluar (për të mbuluar një veprim tjetër juridik).

Në rastin konkret, ky veprim juridik (duke e konsideruar vetëm për qëllimet e posaçme të ligjit nr.10192/2009 si “transferim pronësie”) nuk është me titull barrësor dhe as me titull falas, sipas gjermës “a” dhe pjesës së parë të gjermës “b” të kësaj dispozite.

Ndërsa për sa i përket vlerës së apartamenteve në kontratën mes personave të tretë “xxx” Sh.p.k., “xxx” Sh.p.k. dhe R.Z., ajo është e njëjtë me vlerën e këtyre apartamenteve të përcaktuar në kontratën e porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx të lidhur mes këtyre shoqërive dhe të paditurit R.D. Krahas kësaj, vertetohet se edhe efektivisht nga personi i tretë R.Z. është paguar nëpërmjet bankës shuma xxx euro që përben dy këstet e para të kontratës për prenotim apartamenti nr.xxx kol., nr.xxx rep., dt.xxx (rreth 87% e vlerës) (kësti i tretë dhe i fundit prej xxx euro sipas kontratës është caktuar për t’u paguar deri me dt.xxx). Shumat e mëdha të paguara në zbatim të detyrimeve të kontratës, tregojnë se veprimi juridik nuk është fiktiv.

Po kështu, gjatë gjykimit u krye edhe ekspertimi vlerësues i dy apartamenteve të mësipërme, me qëllim që të përcaktohet vlera e tregut të tyre në kohën e lidhjes së kontratës së mësipërme (me dt.xxx) mes personave të tretë “xxx” Sh.p.k., “xxx” Sh.p.k. dhe R.Z. Ekspertimi vlerësues i kryer nga eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme S.K., depozituar me dt.xxx në gjykatë, konkludoi se vlera e tregut e këtyre apartamenteve me dt.xxx ka qënë në shumën xxx (xxx) euro. Kjo vlerë është e pothuasje e njëjtë (madje pak më e vogël) se vlera e përcaktuar në kontratën e lidhur me personin e tretë R.Z. Në këto kushte, nuk ndodhemi as përpara rastit të përcaktuar në pjesën e dytë të gjermës “b” të nenit 22/5 të ligjit nr.10192/2009 që bën fjalë për transferimet në emër të të tretëve në vlera dukshëm nën vlerën e tregut.

Së katërti, revokimi i kontratës së porosisë dhe lidhja e kontratës për prenotim apartamenti rezulton se është bërë në një kohë kur mbi këto pasuri nuk kishte në fuqi apo të zbatuar asnjë vendim sekuestroje dhe ligjërisht palët kanë qënë të lira të disponojnë mbi këto pasuri. Kështu, këto veprime juridike (të datës xxx) janë kryer pas datës dt.xxx të vendimit të pushimit të çështjes penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx ndaj të paditurit R.D. dhe humbjes së fuqisë së sekuestrove preventive të vendosura ndaj pasurive objekt gjykimi me vendimet nr.xxx, dt.xxx dhe nr.xxx, dt.xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx. Nga ana tjetër, rezulton se në datën xxx kur janë kryer veprimet e mësipërme juridike, akoma nuk ishte ekzekutuar nga Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor xxx vendimi nr.x, dt.xxx i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda xxx që vendosi sekuestron e këtyre pasurive sipas nenit 11 të ligjit nr.10192/2009. Nga shkresa nr.xxx prot., dt.xxx e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të

Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe procesverbali dt.xxx i Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor xxx që ndodhet bashkëngjitur saj, të marra si prova në gjykim, rezulton se vendimi i sekuestrimit nr.x, dt.xxx i kësaj gjykate, për dy apartamentet e ndodhura në xxx, është ekzekutuar, sipas nenit 14 të ligjit nr.10192/2009, me dt.13.12.2011.

Prandaj në këto kushte, gjykata çmon se edhe kërkesa e prokurorisë me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik “revokim kontrate” nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx dhe kontratës për prenotim apartamenti nr.xxx kol., nr.xxx rep., dt.xxx për sa i përket vlerës prej xxx euro të paguara nga i padituri R.D., është pabazuar.

7. Për gjithë sa më sipër, gjykata arrin në **përfundimin se duhet rrëzuar si e pabazuar kërkesa (padia) e Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë**, me objekt **konfiskimin** për pjesën që përfaqëson vlerën xxx euro të dy apartamenteve të ndodhura në xxx për të cilat i padituri R.D. kishte lidhur kontratën e porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx dhe **konstatimin e pavlefshmërisë** së veprimit juridik “revokim kontrate” nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx dhe të kontratës për prenotim apartamenti nr.xxx kol., nr.xxx rep., dt.xxx për pjesën e vlerës prej xxx euro.

Me rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pjesës përkatëse të aparatmenteve të ndodhura në xxx dhe me pushimin e gjykimit të kërkesës për konfiskimin e apartamentit të ndodhur në xxx, gjykata **revokon edhe masën e sekuestros** të marrë ndaj këtyre pasurive me vendimin nr.x, dt.xxx të kësaj gjykate, disponim i cili, sipas nenit 28/2 të ligjit nr.10192/2009, vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të vendimit, gjithmonë pasi vendimi merr formë të prerë dhe nëse ky disponim mbetet e pandryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, në bazë të neneve 3, 5/2, 7, 21 e vijues të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe neneve 126, 127, 201/1, 299/b, 306 e vijues të K.Pr.Civile,

### **V E N D O S I:**

1) Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë me objekt konfiskimin, për pjesën që përfaqëson shumën xxx (xxx) euro të paguara nga i padituri R.D., të pasurive të mëposhtme:

a) Një apartament banimi me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ndodhur lagjen “xxx”, xxx, në objektin “xxx” në administrim të shoqërive “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k., në katin e gjashtë nga toka, me nr.xx, porositur për t’u ndërtuar nga i padituri R.D. me kontratën e porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx, të lidhur

mes tij dhe shoqërive ndërtuese “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k.

b) Një apartament banimi me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ndodhur lagjen “xxx”, xxx, në objektin “xxx” në administrim të shoqërive “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k., në katin e shtatë nga toka, me nr.xx, i porositur për t’u ndërtuar nga i padituri R.D. me kontratën e porosisë nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx, të lidhur mes tij dhe shoqërive ndërtuese “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k.

2) Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë me objekt konstatimin e pavlefshmërisë, për sa i përket vlerës prej xxx (xxx) euro të paguara nga i padituri R.D., të veprimit juridik “revokim kontrate” me nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx të kryer midis R.D. dhe shoqërive “xxx” Sh.p.k. dhe “xxx” Sh.p.k. dhe të kontratës për prenotim apartamenti me nr.xxx kol., nr.xxx rep., dt.xxx të lidhur midis shoqërive “xxx” Sh.p.k., “xxx” Sh.p.k. dhe R.Z.

3) Pushimin e gjykimit të kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë për pjesën ku kërkohet konfiskimi i apartamentit të banimit me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “xxx”, xxx, i rregjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxx me nr.xxx, zona kadastrale nr.xxx, blerë nga personi i tretë Z.D. me kontratën e shitjes nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx.

4) Revokimin e masës së sekuestros së vendosur në funksion të kësaj çështje ndaj pasurive të mësipërme, me vendimin nr.x, dt.xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

5) Urdhërohen Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor Tiranë dhe xxx, për zbatimin e detyrave që rrjedhin sipas këtij vendimi në lidhje me pasuritë e mësipërme.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë brenda 15 ditëve dhe për pjesën ku është vendosur pushimi i gjykimit ankimi i veçantë brenda 5 ditëve, ku këto afate për palët në mungesë fillojnë nga njoftimi i tyre.

**U shpall në Tiranë, më 06.02.2013.**

**SEKRETARE**

**OLTA SINANAJ**

**GJYQTAR**

**ARDIT MUSTAJ**